



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 560/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Duka” shpk si nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-59610-03-29-2018 me objekt: *Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Selenicë*” me fond limit 65,000,000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 23.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Avduli” shpk & “Shpresa” shpk nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: “Duka” shpk
Lagjia Pavarësia, Rruga “Mato Robi”, Kulla Ferati nr.2, Kati.1 Vlorë

BOE “Avduli” shpk & “Shpresa” shpk
Lagjia “10 Korriku”, Rruga “Perlat Rexhepi”, objekt tre Katësh nr.4, Kati.1 Vlorë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Selenice
Selenice

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010,

“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 29.03.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-59610-03-29-2018 me objekt: *Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Selenicë*” me fond limit 65,000,000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 23.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.

II.2. Në datën 23.04.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Duka	53,667,780	I skualifikuar
- Avduli	58,744,716	I skualifikuar
- Baitel	61,412,700	I skualifikuar

II.4. Në datën 11.05.2018 operatori ekonomik “Duka” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

Shoqëria “DUKA” me oferte 53,667,780 leke pa tvsh

- a. *Ne vertetimin e paraqitur nga subjekti “DUKA” shpk i leshuar nga Bashkia Vlore nuk shenohen datat dhe shumat për shërbimet e realizuara për çdo vit. Ky vertetim përmban vetëm vlerën totale të kontratës por nuk përmban shumat e realizuara për çdo vit. Në pikën 3.3.a të kriterëve të kualifikimit për caktohet se “si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të shoqëruara me situacionet përkatëse”. Subjekti “DUKA” ka paraqitur vertetimin ku përshkruhen shërbimet e kryera, por jo data dhe shumat e realizuara.*
- b. *Plani i biznesit i paraqitur nga subjekti “DUKA” shpk nuk përmban elementet baze të tij si historiku i veprimtarisë së subjektit, përshkrimi i projektit, numri i punonjësve dhe organizimi i punës, vlerësimi i të ardhurave dhe vlerësimi i shpenzimeve gjatë periudhës 5 vjeçare që do të zgjase kryerja e shërbimeve, etj.*
- c. *Subjekti “DUKA” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon një truall, me sipërfaqe prej të paktën 1000 m² brenda territorit të Bashkisë Selenice, e cila të shërbejë për ngritjen e parkut të mjeteve dhe ambienteve ndihmese në funksion të realizimit të këtij shërbimi. Kontrata e qerases e paraqitur në tender është për një tokë bujqësore e tipit arë dhe nuk është për truall sikurse përcaktohet në pikën 3.3.i të kriterëve të vecanta të kualifikimit. Bazuar në ligjin nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar, përcaktohet se “Tokë bujqësore” është sipërfaqja e tokës që si e tillë figuron në regjistrat kadastrale të shtetit, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë. Në ligjin Nr. 131/2014 përcaktohet se “Neni 1 Në nenin 14 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë: c) Pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.”. d) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “4. Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.”.*
- d. *Nga dokumentacioni i paraqitur për mjetin Fadrome me targa VL9866C rezulton se është në emer të subjektit “DUKAJ” shpk i lindur në datë 01.01.1900. Leja e qarkullimit e këtij mjeti është leshuar në datë 27.10.2009, nderkohe që referuar historikut të shoqërisë ndryshimi i emrit nga “DUKA” në “DUKAJ” është bërë në 01.12.2005. Legjislacioni shqiptar parashikon edhe mundësinë e ndryshimit të gjeneraliteteve të mjetit që kryhen pas paraqitjes së dokumentacionit të mëposhtem: “Personi i interesuar për ndryshimin e*

gjeneraliteteve, pranë sporteleve të shërbimit dorëzon këto dokumente: 1. Kërkesë DRM 46, e cila plotësohet pranë sporteleve. Kartë identiteti, e cila pasi fotokopjohet nga punonjësi i shërbimit, ju përsëri. Kur kërkuesi për çregjistrimin e mjetit është subject fizik ose juridikë me ligj regjistrohet në QKB, ekstrakti i QKB-së, verifikohet nëpërmjet numrit NIPT, printohet drejtëpërdrejtë në sportel nga nënpunësi i pranimit dhe legalizohet me vulën e tij personale. Për personin që kryen veprimet duhet autorizim. 3. Certifikatën kontrollit fizik të mjetit (Ky document lëshohet pas kryerjes së kontrollit fizik të mjetit pranë ambjenteve të Drejtorive Rajonale). 4. Lejen e qarkullimit të mjetit. 5. Certifikatën e pronësisë së mjetit” (<http://ëëë.dpshttrr.gov.al/sherbimet/per-mjetet-e-transportit/rregjistrimi-i-mjeteve/ndryshimet-e-dokumentacionit/144-ndryshimi-i-gjenealiteteve-te-pronarit-te-mjetit>) Si perfundim ne te dhenat e subjektit ofertues dhe te dhenat e mjetit nuk perputhen me njera tjetren.

Per gjithcka sa u permend me lart bazuar ne nenin 53 pika 3 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, “Për prokurimin publik” percaktohet se autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Duke qene se kjo oferte ka disa mangesi nuk kualifikohet.

II.5. Në datën 16.05.2018 operatori ekonomik “Duka” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Në lidhje me pikën e parë të skualifikimit ju bëjmë me dije se operatori Duka shpk e ka përmbushur me korektësi sepse sipas kërkesave janë dorëzuar kontrata e punës e ngjashme , Vërtetimi nga autoriteti kontraktor , faturat e firmosura si dhe situacionet përkatëse. Pretendimi juaj që në vërtetimin e punës së ngjashme nuk janë shënuar datat, dhe shërbimet e kryera është absurd sepse ato janë të shënuara në situacionet për muajt përkatës. Prandaj kjo arsye skualifikimi nuk është e bazuar në VKM e Prokurimeve dhe si e tillë kërkojmë që të pranohet nga AK.
- Për sa i përket pikës së dytë të skualifikimit theksojmë se: Plani i biznesit i paraqitur nga ana jonë është një pasqyrë e përgjithshme e aktivitetit që do të kryhet. Për sa i përket nivelit të punësimit, shpenzimeve të kryera , si nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve ato janë të sqaruara në analizën e kostos, specifikimet teknike si dhe në cdo dokument të paraqitur nga ne si operator. Ju bëjmë me dije se autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë një operator me arsye të cilat nuk janë të pasqyruara në kriteret e vecanta të kualifikimit. Në DST e publikuar nga ju nuk kishte asnjë metodë ose udhëzim se si duhej paraqitur plani i biznesit.
- Në lidhje me pikën e tretë të skualifikimit përsëri ju si autoritet i keni tejkalluar kompetencat të cilat ju ka dhënë Ligji dhe VKM e prokurimeve.Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë sepse ne si operator e kemi përmbushur kriterin e kërkuar nga ana juaj në kriteret e vecanta të vlerësimit. Ju nuk mund të skualifikoni një operator në bazë të supozimeve të ndryshme. Ju keni marrë një tagër të cilin e ka një tjetër institucion për ta përdorur. Ne si operator kemi të drejtën e ndryshimit të ambjentit ku ushtrojmë aktivitet, në rastet kur nga ndonjë institucion tjetër do të konstatohen parregullsi. Ky kriter është i përmbushur nga ana jonë në momentin e hapjes së ofertave pasi është në sasinë e duhur dhe në zonën ku ju e keni kërkuar.

- Në pikën e katërt të skualifikimit duket qartë që ju si autoritet keni abuzuar shumë me pretendimet tuaja. Automjeti tip fadromë është në pronësi të operatorit Duka dhe emërtimi në lejen e qarkullimit dhe certifikatës së pronësisë me emrin Dukaj nuk përbën asnjë shkelje sepse është po i njëjti pronar vetëm sepse në vitin 2005 kemi ndryshuar emrin kjo e pasqyruar edhe në ekstraktin historik. Ky mjet është i pasqyruar edhe në bilancet e shoqërisë. Këtë fakt e vërteton edhe Nr. Nipt J77411203S i cili është i pasqyruar në certifikatën e pronësisë, policën e sigurimit si dhe në pagesën e taksave.

II.6. Në datën 24.05.2017 me shkresën nr. 1233/2. 1237/2 prot, operatori ekonomik ankimues “Duka” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së ankimeusit.

II.7. Në datën 30.05.2018, pala ankimuese “Duka” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 11.05.2018 BOE “Avduli” shpk& “Shpresa” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- B.O.E “AVDULI”&”SHPRESA” me oferte 58,744,716 leke pa tvsh
-
- a) *Subjekti “Avduli” për të provuar se disponon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit ka paraqitur fatura tvsh me subject privat “BAD” shpk. Nga 5 faturat e paraqitura (pasi fatura nr.20 dt.30.06.2015 është paraqitur dy here), fatura nr.25 dt.26.12.2014 dhe nr.9 dt.30.03.2015, janë jashtë afatit 3 vjeçar të kerkuar në kriterin e kualifikimit. Vlera e 3 faturave të vlefshme është 9,384,720leke, për pasojë ky subjekt nuk mund të marrë me teper se 16 % në kontratën e bashkepunimit.*
- b) *Subjekti “Avduli” nuk ka paraqitur licence nga QKB përkatësinë III.1.A. Leje mjedisore e tipit C për :Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane. Licenca me këto kategori e paraqitur në tender është për ”Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme. Magazinimi dhe shkarkimi në masë të madhe të cimentos Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve”. Kjo licence nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.*
- c) *Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Subjekti “Avduli” për të provuar se disponon 1 (nje) mjek ndërmarrjeje të punësuar, rezulton se Mjekut I ka perfunduar licenca në date 05.03.2018*
- d) *Subjekti “Avduli” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon një truall, me sipërfaqe prej të pakten 1000 m2 brenda territorit të Bashkisë Selenice, e cila të shërbejë për ngritjen e parkut të mjeteve dhe ambienteve ndihmese në funksion të realizimit të këtij shërbimi. Kontrata e qerash e paraqitur në tender është për një toke bujqesore e tipit arë dhe nuk është për truall sikurse përcaktohet në pikën 3.3.i të*

kritereve te vecanta te kualifikimit. Bazuar ne ligjin nr.9244, date 17.6.2004 "Per mbrojtjen e tokesbujqesore" indryshuar, percaktohet se "Toke bujqësore" është sipërfaqja e tokës që si e tille figuron ne regjistrat kadastrale te shtetit, e zëne me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore te saj pjellorinë. Ne ligjin Nr. 131/2014 percaktohet se "Neni 1 Në nenin 14 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë: a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë: "1. Ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.". b) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: "4. Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral."

- e) Subjekti "Avduli" shpkkaparaqitur dokumentacion se disponon mjetet si me poshte
- - Mjetit me targa AFMT15 i mungon pagesa e taksave, kolaudimi
 - - Mjeti me targa VL1026C eshte me dokumentacion te perfunduar afati ne 23.03.2018
 - - Mjeti me targa AA258EV eshte me peshe mbi 18 ton dhe me taksat te perfunduara ne date 21.11.2017
 - - Mjeti me targa VL5873C eshte me peshe mbi 18 ton dhe me taksat te perfunduara ne date 27.12.2017
 - - Mjeti me targa AA188BD eshte me peshe 3,2 ton
 - - Mjeti me targa AA443DF eshte me peshe 1,4 ton
 - - Mjeti me targa TR5429I eshte me peshe 2,1 ton dhe me taksat te perfunduara ne date 28.03.2018
- f) Vertetimi i paraqitur nga subjekti "Shpresa" shpk per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore e percakton se ka kontribute te pashlyera.
- g) f. Subjekti "Shpresa" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon nje truall, me sipërfaqe prej te pakten 1000 m2 brenda territorit te Bashkise Selenice, e cila te sherbeje per ngritjen e parkut te mjeteve dhe ambienteve ndihmese ne funksion te realizimit te ketij sherbimi.
- h) Subjekti "Shpresa" shpk nuk ka paraqitur licencenga QKB përkatësinë III.1.A Lejmjedisi e tipit C përaktivitetin: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme Per gjithcka sa u permend me lart bazuar ne nenin 53 pika 3 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, "Për prokurimin publik" percaktohet se autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Duke gene se kjo oferte ka disa mangesi nuk kualifikohet.

II.9. Në datën 16.05.2018 BOE "Avduli" shpk & "Shpresa" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- Shoqëria Avduli shpk për të plotësuar kriterin e punës së ngjashme ka paraqitur 5 fatura tatimore nga të cilat fatura që është e vitit 2014 nuk merret në kosnideratë. Katër fatturat e tjera dhe konkretisht: ajo me Nr.20 datë 30.06.2015 me vlerë 2,499,720 lekë pa tvsh, Nr.09

datë 30.03.2015 me vlerë 3,340,500 lekë pa tvsh, Nr.12 datë 27.05.2015 me vlerë 3,893,000 lekë pa tvsh, Nr.13 datë 24.07.2015 me vlerë 2,992,000 lekë pa tvsh. Të katërta janë të vlefshme pasi janë të katërta të vitit 2015 brenda tre viteve të fundit. Kur themi punë të ngjashme në tre vitet e fundit dmth që i përkasin vitit 2015,2016,2017. Nuk u kuptojmë përderisa faturat janë të vitit 2015 KVO i ka nxjerë të pavlefshme.

- Lidhur me arsyen e skualifikimit se Subjekti “Avduli” nuk ka paraqitur licence nga QKB për kategorinë III.1.A. Leje mjedisore e tipit C për :Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane. Licenca me kete kategori e paraqitur ne tender eshte per ”Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme. Magazinimi dhe shkarkimi ne mase te madhe i cimentos Riparimi dhe mirembajtja e makinerive dhe pajisjeve”. Kjo licence nuk ka lidhje me objektin e prokurimit”, ju sqarojmë se referuar kriterëve të kualifikimit është kërkuar: Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB për kategorinë III.1.A. Leje mjedisore e tipit C për : Shërbimi i pastrimit dhe i largimit të mbeturinave urbane. Subjekti te jete i pajisur me licence nga QKB për kategorinë III.1.A Leje mjedisi e tipit C për aktivitetin: Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme. Për të plotësuar këto kërkesa shoqëria Avduli shpk dhe shoqëria Shpresa shpk kanë paraqitur leje mjedisore e tipit C me kod III.1.A dhe Licencë me kod III.2.B nga QKB. Pra këto dokumenta që janë paraqitur plotësojnë dy pikat e kërkuara nga AK pasi po ti referohemi përshkrimit të lejes mjedisore dhe licencës janë të njëjta me ato që kërkohen nga AK. Këto pika plotësohen nga të dy operatorët edhe nga Avduli shpk dhe Shpresa shpk.
- Për sa i përket pretendimit që mjekut të shoqërisë Avduli i ka përfunduar Licenca sqarojmë se në rast se ky kriter nuk plotësohet nga shoqëria Avduli rezulton se është plotësuar nga shoqëria Shpresa shpk e cila ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi mjeken me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ju. Në DT nuk është parashikuar që mjekun në rast BOE ta kenë të dyja shoqëritë. Në këto kushte pretendojmë se ky kriter është përmbushur nga shoqëria Shpresa shpk e si rrjedhimky pretendim i AK nuk përbën kusht për skualifikim.
- Në vazhdim është pretenduar se shoqëria Avduli shpk nuk ka paraqitur kontratë për truall prej 1000 m2 por kontrata e paraqitur është për një tokë bujqësore e tipit arrë dhe nuk është truall sic është kërkuar në DT. Në kriteret për kualifikim është kërkuar: Subjekti ofertues duhet të disponojë (në pronësi ose qera) një truall me sipërfaqe 1000 m2 brenda teritorit të Bashkisë Selenicë e cila të shërbejë për ngritjen e parkut të mjeteve dhe ambjentëve ndihmëse në funksion të realizimit të këtij shërbimi. Pretendimi i KVO nuk qëndron pasi shoqëria Avduli shpk ka paraqitur në kontratë qeraje me sipërfaqe më shumë se 1000 m2 në të cilën kontratë është cilësuar qartë se destinacioni i përdorimit të kësaj toke do të jetë me qëllim ambjent shërbimi për parkimin e mjeteve të rënda të firmës Avduli si dhe materialet ndihmëse të punëve që kryhen shoqëria. Pra sipërfaqja që ne kemi marrë me qera është tokë ku është e gatshme të funksionojë për nevojat e shoqërisë sonë.
- Për sa u përket mjeteve që shoqëria Avduli ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi ju sqarojmë sa më poshtë:
- Mjetit me targa AFMT15 i mungon pagesa e taksave, kolaudimi: Ju lutem bashkëngjitur kontratës janë edhe pagesa e taksave dhe kolaudimi të vlefshme.

- Mjeti me targa VL1026C është me dokumentacion te perfunduar afati ne 23.03.2018: Ky mjet nuk është paraqitur fare nga shoqëria Avduli shpk dhe nuk e kuptojmë ku e keni gjetur.
- Mjeti me targa AA258EV është me peshe mbi 18 ton dhe me taksat te perfunduara ne date 21.11.2017
- Mjeti me targa VL5873C është me peshe mbi 18 ton dhe me taksat te perfunduara ne date 27.12.2017; Ky mjet e ka të gjithë dokumentacionin e kërkuar përderisa ka dalë certifikata e kontrollit teknik dhe polica e sigurimit është shumë e qartë që taksa vjetore është paguar. Pasi në asnjë mënyrë nuk mund të marrim certifikatën e kontrollit teknik pa paguar taksën vjetore
- Mjeti me targa AA188BD është me peshe 3,2 ton: sqarojmë se ky mjet nuk është paraqitur në këtë procedurë prokurimi.
- Mjeti me targa AA443DF është me peshe 1,4 ton
- Mjeti me targa TR5429I është me peshe 2,1 ton dhe me taksat te perfunduara ne date 28.03.2018: sqarojme se ky mjet nuk i ka taksat të përfunduara në datën 28.03.2018, është me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana juaj dhe i vlefshëm. Gjithashtu kriteri për kamionat është plotësuar edhe nga shoqëria Shpresa shpk e për pasojë nuk ka arsye për skualifikim.
- Lidhur me arsyen e skualifikimit se “Vertetimi i paraqitur nga subjekti “Shpresa” shpk per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore e percakton se ka kontribute te pashlyera”, ju sqarojmë se shoqëria Shpresa nuk ka detyrime fakt i cili mund të vërtetohet nga FDP , urdhërpagesat dhe faturat e bankës për të gjithë periudhën që ju keni kërkuar. Ju lutem referohuni listpagesave dhe FDP të shoqërisë Shpresa shpk të paraqitura në këtë procedurë prokurimi.
- Në përfundim është pretenduar se shoqëria Shpresa nuk ka paraqitur kontratë për truall në teritorin e Bashkisë Selenicë. Në kriteret për kualifikim nuk është kërkuar që në rast bashkimi të OE-ve ky kriter të përmbushet nga të dyja shoqëritë qa marrin pjesë në bashkëpunim.
- Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.

II.10. Në datën 24.05.2018, me shkresën nr.1233/2 prot dhe 1237/2 prot, BOE “Avduli” shpk& “Shpresa” shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.11. Në datën 31.05.2018 BOE “Avduli” shpk& “Shpresa” shpk shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr.1511 prot, datë 08.06.2018, protokolluar me tonën me nr.1020 prot datë 12.06.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorëve ekonomikë ankimues “Duka” shpk dhe BOE “Avduli shpk& “Shpresa” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “Subjekti “DUKA” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon nje truall, me sipërfaqe prej te pakten 1000 m2 brenda territorit te Bashkise Selenice, e cila te sherbeje per ngritjen e parkut te mjeteve dhe ambienteve ndihmese ne funksion te realizimit te ketij sherbimi. Kontrata e qerese e paraqitur ne tender eshte per nje toke bujqesore e tipit arre dhe nuk eshte per truall sikurse percaktohet ne piken 3.3.i te kriterëve te vecanta te kualifikimit. Bazuar ne ligjin nr.9244, date 17.6.2004 “Per mbrojtjen e tokes bujqesore” i ndryshuar, percaktohet se “Toke bujqësore” është sipërfaqja e tokës që si e tille figuron ne regjistrat kadastrale te shtetit, e zëne me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore te saj pjellorinë. Ne ligjinNr. 131/2014 percaktohet se “Neni 1 Në nenin 14 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë: c) Pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.”. d) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “4. Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.”

Si dhe Subjekti “Avduli” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion se disponon nje truall, me sipërfaqe prej te pakten 1000 m2 brenda territorit te Bashkise Selenice, e cila te sherbeje per ngritjen e parkut te mjeteve dhe ambienteve ndihmese ne funksion te realizimit te ketij sherbimi. Kontrata e qerese e paraqitur ne tender eshte per nje toke bujqesore e tipit arre dhe nuk eshte per truall sikurse percaktohet ne piken 3.3.i te kriterëve te vecanta te kualifikimit. Bazuar ne ligjin nr.9244, date 17.6.2004 “Per mbrojtjen e tokes bujqesore” i ndryshuar, percaktohet se “Toke bujqësore” është sipërfaqja e tokës që si e tille figuron ne regjistrat kadastrale te shtetit, e zëne me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtat, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore te saj pjellorinë. Ne ligjin Nr. 131/2014 percaktohet se “Neni 1 Në nenin 14 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë: a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë: “1. Ndalohet veprimtaria ndërtimore në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.”. b) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “4. Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 3.3/i “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Subjekti ofertues duhet te disponoje (ne pronesi ose qira) nje truall, me sipërfaqe prej te pakten 1000 m2 brenda territorit te Bashkise Selenice e cila te sherbeje per ngritjen e parkut te mjeteve dhe ambienteve ndihmese ne funksion te realizimit te ketij sherbimi.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Duka” shpk dhe bashkimi i opearatorëve ekonomikë “Avduli” shpk & “Shpresa” shpk kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Duka shpk

- Kontratë Qeraje Nr.1369 Rep, Nr.969/2 Kol Lidhur më datë 03.04.2018, ndërmjet E. D në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Duka në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënie me qera të një sipërfaqeje prej 1000 m2 tokë bujqësore e ndodhur në Lubonjë, Vlorë, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi datë 22.07.20103 me nr. Regj 1825/3. Bashkëngjitur Kontratës së Qerase Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi Nr.18125/3 datë 22.07.2003

BOE Avduli shpk&Shpresa shpk

- Kontratë Qeraje Nr.865 Rep, Nr.545 Kol datë 21.04.2018 lidhur ndërmjet V.K në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë Avduli shpk në cilësinë e qeramarrësit me objekt dhënie me qera e pasurisë tokë arë me sipërfaqe 4000 m2 e ndodhur në Treblovë Vlorë, pasuri e përfituar nga ligji nr.7501 datë 19.07.1991. Bashkëngjitur kontratës së qerasë Certifikata për vërtetim pronësie dhe Kartela e Pasurisë.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Neni 28, pika 5, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) “Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”..

III.1.5. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kërkesat kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumentacion provues se disponojnë (ne pronesi ose qira) **nje truall**, me sipërfaqe prej te pakten 1000 m2 brenda territorit te Bashkise Selenice e cila te sherbeje per ngritjen e parkut te mjeteve dhe ambienteve ndihmese ne funksion te realizimit te ketij sherbimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes "Duka" shpk dhe bashkimi i operatorëve ekonomikë "Avduli" shpk & "Shpresa" shpk rezulton se kanë dorëzuar dokumentacion lidhur me disponimin nëpërmjet kontratës së qerasë përkatësisht të një sipërfaqeje prej 1000 m2 tokë bujqësore për Duka shpk dhe tokë arë me sipërfaqe 4000 m2 për BOE Avduli & Shpresa shpk.

III.1.6. Referuar Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" Neni 3 pika 7 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Truall" është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.*

III.1.7. Ndërsa Neni 2 i Ligjit Nr.9244, datë 17.6.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore" jep këtë përkufizim lidhur me tokën bujqësore: *"Tokë bujqësore" është sipërfaqja e tokës që si e tillë figuron në regjistrat kadastralë të shtetit, e zënë me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtet, kudo ku ndodhet dhe që ka veçori thelbësore të saj pjellorinë.*

III.1.8. KPP referuar përkufizimeve sa më sipër të parashkuara në legjislacionin përkatës lidhur me konceptin e tokës truall dhe konceptin e tokës bujqësore gjykon se destinacioni dhe natyra e këtyre 2 kategorive të tokës është krejtësisht e ndryshme ndaj dhe ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë funksionin që ato kanë. KPP referuar kriterit sa më sipër të përcaktuar nga autoriteti kontraktor gjykon se në të është kërkuar shprehimisht dhe në mënyrë të qartë se operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi do të dyhet të provojnë me anë të dokumentacionit konkret se disponojnë në një nga format e lejuar ligjore **një truall** me sipërfaqe 1000 m2 dhe në asnjë rast nuk është kërkuar një sipërfaqe cfardo toke sikundër tokë bujqësore apo tokë arrë. Në këtë kuptim KPP gjykon se në kushtet kur kriteri ka përcaktuar qartësisht se sipërfaqja e tokës do të jetë truall dhe nga ana tjetër legjislacioni në fuqi ka një përkufizim të qartë lidhur me kategoritë e tokës dhe klasifikimit të tyre operatorët ekonomikë duhet të dispononin pikërisht sipërfaqen e kërkuar të llojit truall.

KPP gjykon se operatorët ekonomik kanë qenë në dijeni të kësaj kërkesë dhe ishin të ndërgjegjshëm se disponimi i një sipërfaqe cfardo toke e cila nuk është ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor do të përbënte rrezik potencial për skualifikim.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesve “Duka” shpk dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Avduli” shpk & “Shpresa” shpk nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Duka” sh.p.k dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Avduli & Shpresa shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomikë ankimeus do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Duka” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-59610-03-29-2018 me objekt: *Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Selenicë*” me fond limit 65,000,000 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 23.04.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Avduli” shpk & “Shpresa shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1020 Protokoli, Datë 30.05.2018

Nr.1028 Protokoli, Datë 31.05.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëta
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha